

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram® CleanGrout

BOJAK ME BAZË ÇIMENTOJE PËR FUGA DYSHEMEJE/MURI ME GJERËSI 1 - 8 MM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram® CleanGrout është bojak në formë pluhuri më bazë çimentoje për fuga me gjerësi 1–8 mm. Aditivët që përmban pluhuri ofrojnë mbrojtje ndaj mykut, zhvillimit të baktereve dhe kërpudhave ndërsa ruan një ngjyrë të qëndrueshme, rezistencë ndaj abrazionit, padepërtueshmëri nga uji dhe finiturë të qëndrueshme. Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

PËRDORIMET

Mbushje fugash për llojet e mëposhtme të pllakave:

- Qeramike
- Pllaka argjili (earthenware)
- Mozaik qelqi
- Mermer dhe gurë të tjerë natyrorë
- Grës porcelain

Mbushje fugash për aplikimet e mëposhtme me performancë dhe kërkesa të larta:

- Pishina
- Dysheme me ngrohje
- Mjedise tregtare / industriale / rezidenciale
- Fasada

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim mbi dysheme dhe mur
- I papërshkueshëm nga uji
- Rezistencë ndaj abrazionit
- Gradë e lartë fortësie
- Rezistencë ndaj rrezeve UV
- Kundër ngrirjes
- Përmban mbrojtës kundër mykut

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	I modifikuar me polimere, me bazë çimento portland, me rërë të hollë silici/kuarci të përzgjedhur, aditivë për mbajtje uji dhe aditivë të tjerë të posaçëm.				
Ambalazhi	qese alumini 5 kg dhe 2 kg				
Paraqitja / Ngjyra	Ngjyrat:				
	White	Light Grey	Silver	Manhattan	Ice
	Grey	Ash	Anthracite	Graphite	Total black
	Pergamon	Jasmine	Anemone	Beige	Pine
	Caramel	Maple wood	Dove Grey	Light Sand	Sand
	Cedar	Beech wood	Walnut	Oak wood	Brown
	Terracotta	Amaranth	Ruby	Dark Brown	Mahogany
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit				
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të pahapur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C +30°C. Referohuni gjithmonë tek ambalazhi.				

Përmasa maksimale e kokrrizës	D _{max} : 0,25 mm	
Deklarata e produktit	CG2WA	(EN 13888)
Përthithja e ujit	Pas 30 min	≤ 1 g
	Pas 240 min	≤ 3 g

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	≤ 1000 mm ³	(EN 12808-2)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	Pas magazinimit në vend të thatë	≥ 20 N/mm ²
	Pas cikleve ngrirje/shkrirje	≥ 15 N/mm ²
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Pas magazinimit në vend të thatë	≥ 4 N/mm ²
	Pas cikleve ngrirje/shkrirje	≥ 3 N/mm ²
Tkurrja	≤ 3 mm/m	(EN 12808-4)
Rezistenca mikrobiologjike	Mbijetesë bakteresh	0 %
	Kolonizim	Nuk ka zhvillim
		(Protokolli CCB - RP 335/10/S)
Gjerësia e fugës	1–8 mm	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	qese 5 kg	~1,3 litra ujë	(26 % ± 1 %)
	qese 2 kg	~0,5 litra ujë	(26 % ± 1 %)

Dendësia e llaçit të freskët	~2,05 kg/l
-------------------------------------	------------

Konsumimi

Konsumimi varet nga përmasat e pllakave, gjerësia dhe thellësia e fugës. Për udhëzim, konsumimi tregohet në tabelën e mëposhtme dhe shprehet në g/m².

Përmasat e pllakës Gjerësia e fugës

Centimetra	2 mm	3 mm	5 mm	8 mm
Mozaik qelqi 2 × 2 × 0,4	1300	-	-	-
5 × 5 × 0,4	450			
10 × 10 × 0,6	350	500	840	1350
15 × 15 × 0,9	350	500	840	1350
20 × 20 × 0,9	250	380	630	1000
30 × 30 × 1	190	280	470	750
30 × 60 × 1	140	210	350	560
50 × 50 × 1	110	170	280	450
60 × 120 × 1,1	80	110	200	310

Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material për shkak të porozitetit apo profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Konsumimi mund të përlogaritet gjithashtu me formulën e mëposhtme:
Konsumimi (g/m²) = A × B × [(C + D)/(C × D)] × 140.

A = gjerësia e fugës (mm)

C = gjatësia e pllakës (cm)

B = lartësia e pllakës (mm)

D = gjerësia e pllakës (cm)

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.
-------------------------------	--------------------------

Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +35 °C max.
----------------------------------	--------------------------

Koha e punueshmërisë	~2 orë
-----------------------------	--------

Koha e pritjes

Përpara mbushjes së fugave të pllakave të dyshemeve të shtruara me:

Kollë me tharje normale	24–36 orë
Kollë me tharje të shpejtë	4–6 orë
Kollë e shtruar me shtresë të trashë (tradicionale)	8–10 ditë

Përpara mbushjes së fugave të pllakave të mureve të shtruara me:

Kollë me tharje normale	4–6 orë
Kollë me tharje të shpejtë	2 orë

Kohët e mësipërme janë treguese. Këshillohuni gjithmonë me skedën teknike përkatëse të kollës që do të përdoret.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Përdorimi	Koha e pritjes
Qarkullim këmbësorësh	24–36 orë
Trafik i plotë	~14 ditë
Zhytje në ujë	~21 ditë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Kontrolloni nëse fugat janë të thata, të pastra dhe pa asnjë mbetje bojaku, ndotësish dhe distancues pllakash. Hiqini nga fugat përpara aplikimit të bojakut. Për aplikime në klimë / mjedis të nxehtë, ose mbi nënshtresa absorbuese, menjëherë lagni paraprakisht të gjithë sipërfaqen përpara aplikimit të produktit. Shmangni grumbullimin e ujit mbi sipërfaqe. Sipërfaqja nuk duhet të jetë e lagësht në prekje.

PËRZIERJA

Hidheni sasinë e rekomanduar të ujit të pastër dhe të ftohtë brenda një ene të pastër dhe të përshtatshme për përzierje. Shtoni ngadalë pluhurin SikaCeram® CleanGrout brenda ujit ndërsa jeni duke përzierë me një mikser në shpejtësi të ulët (~500 rpm). Pastaj, përzieni derisa materiali të jetë përzierë plotësisht dhe të mos ketë kokrriza. Shmangni bllokimin e ajrit brenda miksit nga përzierja e tepërt. Lëreni produktin të qëndrojë për 2–3 minuta përpara se të përzieni sërish edhe për 30 sekonda. Miksi përfundimtar ka konsistencë kremoze, ngjyrë të njëtrajtshme dhe aplikohet dhe përhapet me lehtësi. Për zona ku kërkohen vetëm sasi të vogla, përzierja mund të bëhet edhe manualisht. Masni raportin ujë : pluhur me kujdes pasi diferencat e vogla mund të çojnë në ndryshime të ngjyrës. Për aplikime me performancë dhe kërkesa të larta, si dyshemetë me trafik të rëndë, fasadat e ekspozuara, pishinat ose për fleksibilitet shtesë, uji mund të zëvendësohet me tretësirën SikaCeram® Latex-Grout (lexoni skedën teknike të produktit).

APLIKIMI

Përpara mbushjes së fugave të pllakave, kontrolloni nëse kolla është tharë plotësisht. SikaCeram® CleanGrout aplikohet me vegël të përshtatshme, si mallë, shkop gome (squeegee) ose shpatull. Mbushni dhe ngjeshni plotësisht fugat në mënyrë

tënjëtrajtshme.

Nëse kërkohet, finironi bojakun ndërsa është ende i lagur.

Duke përdorur të njëjtën mallë/shpatull, hiqni bojakun e tepruar nga sipërfaqja me pllaka duke lëvizur veglën diagonal me fugat.

Kur bojaku të jetë i thatë në prekje, përdorni një sfungjer të lagur ose mallë me sfungjer për të pastruar sipërfaqen me pllaka. Pastroni rregullisht sfungjerin me ujë të pastër.

Kur bojaku të jetë ngurtësuar mjaftueshëm brenda fugës (i fortë në prekje me thoin e gishtit), pastroni sipërfaqen me pllaka duke i fshirë me një copë të thatë, të pastër dhe të butë.

Nëse brenda miksit të bojakut, është hedhur SikaCeram® LatexGrout në vend të ujit, pastroni menjëherë sipërfaqen e pllakave pas pastrimit fillestar me një sfungjer të lagur.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë të pastër menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos tejkalo sasinë e rekomanduar të ujit tek miksi. Miksi nuk duhet të jetë asnjëherë fluid.
- Mos shtoni apo lejoni të shtohet ujë shtesë tek SikaCeram® CleanGrout gjatë ose pas përzierjes.
- Parandaloni kontaktin e materialit të freskët të aplikuar me ujin (përfshirë shiun), me përjashtim gjatë pastrimit. Parandaloni gjithashtu ekspozimin me lagështinë atmosferike / kondensimin e tepruar ose lagështinë e mbetur tek nënshtresa, etj.
- Shmangni variacionet e mëdha të temperaturës gjatë kohës së aplikimit dhe mpiksjes, gjithashtu kalimit të tepruar të ventilimit ose erës.
- Uji dhe ventilimi i tepruar, ndryshimet në temperaturë, aplikimi mbi pllaka ose nënshtresa shumë poroze që përthithin me shpejtësi ujin, etj. mund të çojë në ndryshim të ngjyrës.
- Kur aplikohet bojak me ngjyrë për estetikë, si p.sh. mbi porcelan të pastruar ose pllaka guri

natyror, kryeni gjithmonë një testim pastrimi mbi një zonë të vogël përpara aplikimit të plotë.

- Mbi pllakat me absorbueshmëri të lartë, rekomandohet gjithmonë lagia paraprake e të gjithë sipërfaqes përpara mbushjes së fugave të pllakave me bojak.
- SikaCeram® CleanGrout duhet të aplikohet gjithmonë me një veprim të vazhdueshëm dhe nuk duhet të ndërpritet për më shumë se 2 orë në të njëjtën dhomë ose zonë ku po shtrohen pllakat. Ekspozimi i parakohshëm i miksit ndaj ujit apo ujit të tepruar mund të shkaktojë efloreshencë mbi sipërfaqen e bojakut.
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor për të shmangur plasaritjet mbi fugat.
- Sigurohuni se bojaku është tharë mjaftueshëm përpara kryerjes së pastrimit të pllakave për të shmangur heqjen e bojakut nga fuga.
- Mos shtoni asgjë që nuk specifikohet në këtë skedë teknike brenda produktit.
- Të mos përdoret për asnjë aplikim që nuk përshkruhet në mënyrë eksplicite në këtë skedë teknike.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram® CleanGrout

Shtator 2019, Botimi 03.01

020404010010000006

SikaCeramCleanGrout-sq-AL-(09-2019)-3-1.pdf